**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# VENDIM

Nr. 162, datë 03.11.2023

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 3'027'745 LEKË AKORDUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË PËR GRANTIN E MENJËHERSHËM, PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË ULJE TË VLERËS SË KONTRATËS**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 555, datë 15.07.2020 "Për proçedurat, kriteret dhe përparsitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit", Shkresës nr.11354/3 prot, datë 14.07.2023, protokolluar me tonën nr. 6792 prot, datë 18.07.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Strehimit në lidhje me miratimin e fondit prej 3'027'745 lekë, ("Mbi fondet për grantin e menjëhershëm" së bashku me listën e familjeve që përfitojnë ulje të vlerës së kontratës) për grantin e menjëhershëm dhe sipas relacionit të përgatitur nga Komisioni i Strehimit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 3'027'745 (tre milion e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e dyzetepesë) lekë, akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për grantin e menjëhershëm, për familjet që përfitojnë ulje të vlerës së kontratës.

2. Fondi prej 3'027'745 (tre milion e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e dyzetepesë) lekë, do të përdoret për uljen e vlerës së kontratës për çdo familje përfituese sipas tabelës bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Drejtoria Ekonomike ngarkohet të kryejë procedurat për kalimin e fondit në llogari të Entit Kombëtar të Banesave si dhe Bankës Kombëtare Tregtare.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DURRËS

**U shpall sot me datë 06.11.2023**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DURRËS SEKRETARIA

Tabela nr. 1

Lista e familjeve që përfitojnë nga granti i menjëhershëm nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

| Nr. Fam ilje | EMER/MBIEMER | Gjëndja familjare | VKB që e ka miratuar | Statusi (I Verbër, PAK, jetim) | Vlera e Kontratës totale | Vlera e këstit mujor | % e Grantit nga Buxheti | Vlera e grantit që përfiton | NR LLOGARISE IBAN | EMRI LLOGARISE IBAN | EMRI I BANKËS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Arianit Fatmir Vasjari | 3 | VKB Nr.594 dt.11/03/2019-EKB | b. PAK, | 2054546 | 10236.62 | granti 10 % | 205455 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 2 | Marjana Parim Muçollari | 3 | VKB Nr.594 dt.11/03/2019-EKB | b. PAK, | 2065553 | 10611.95 | granti 10 % | 206555 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 3 | Velino Edmond Turku | 3 | VKB Nr.594 dt.11/03/2019-EKB | b. PAK, | 2058215 | 11207.39 | granti 10 % | 205822 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 4 | Kasem Nazif Nebiu | 2 | VKB Nr.594 dt.11/03/2019-EKB | b. PAK, | 2116916 | 11048.63 | granti 10 % | 211692 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 5 | Suela Urim Methoxha | 2 | VKB Nr.594 dt.11/03/2019-EKB | b. PAK, | 2028854 | 6759.86 | granti 10 % | 202885 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 6 | Zija Behexhet Shehi | 5 | VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB | b. PAK, | 1246738 | 5124.4 | granti 10 % | 124674 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 7 | Feti Saliko Sadikaj | 3 | VKB Nr.129 dt.28/10/2001-EKB | b. PAK, | 1220523 | 5936 | granti 10 % | 122052 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 8 | Robert Tajar Shkurta | 2 | VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB | b. PAK, | 1233329 | 6183 | granti 10 % | 123333 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 9 | Bujar Tajar Shkurta | 5 | VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB | b. PAK, | 1175335 | 5717 | granti 10 % | 117534 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 10 | Ilir Selam Allaraj | 7 | VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB | b. PAK, | 1859793 | 9046 | granti 10 % | 185979 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 11 | Ylli Azbi Veliko | 2 | VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB | b. PAK, | 1830571 | 8928 | granti 10 % | 183057 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 12 | Sokol Muharrem Neziro | 6 | VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB | b. PAK, | 1132688 | 5730 | granti 10 % | 113269 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 13 | Mirjan Lytfi Rapçe | 4 | VKB Nr.129 dt.28/10/2001-EKB | b. PAK, | 1168965 | 5686 | granti 10 % | 116897 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 14 | Hajrulla Imshaqir Balliu | 3 | VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB | b. PAK, | 1970854 | 9586 | granti 10 % | 197085 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 15 | Ervin Shpëtim Leka | 6 | VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB | b. PAK, | 1559436 | 7888 | granti 10 % | 155944 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 16 | Ruzhdi Nexhip Kanapari | 5 | VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB | b. PAK, | 2061171 | 10123 | granti 10 % | 206117 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 17 | Ismet Imshaqir Balliu | 4 | VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB | b. PAK, | 1166626 | 5674 | granti 10 % | 116663 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| 18 | Dhurata Haxhi CAKRRI | 3 | VKB Nr.200 dt.24/2/2010-EKB | Anëtar i kom. Egjiptian | 2327329 | 9824.3 | granti 10 % | 232733 | :0200000548 | Enti Kombëtar Banesave Durrës | Raiffeisen BANK |
| | TOTALI | | | | | | | 3027745 | | | |

Shënim : Përfundon me numër rendor 18 (tetëmbedhjete)

**TOTALI I GRANTIT TE MENJEHERSHEM.........3 027 745 lek**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DURRËS SEKRETARIA

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT DURRËS**

Nr.709/2 prot. Durrës, më 13.11.2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

BASHKIA DURRËS
13.11.23 Nr 10222/7

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.162 datë 03.11.2023 "Për miratimin e përdorimit të fondit prej 3'027'745 lekë akorduar nga ministria e financave dhe ekonomisë për grantin e menjëhershëm për familjet që përfitojnë ulje të vlerës së kontratës ".

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" (neni 8/a) "Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore".

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karkater individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT DURRËS